



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**  
**TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**  
**LEZHË**

**Lezhë, më :18. 02.2026**

**NJOFTIM**  
**PËR VEND VAKANT NË POZICIONIN E PUNËS “FTUES”**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë , duke u bazuar në Ligjin Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përmbushje të organikës Nr. 120/ 6 datë 26.01.2026 të Prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për vitin 2026 , me qëllim plotësimin e vendit vakant në strukturën e institucionit :

-Kërkon të punësojë 1 (një) punonjës në pozicionin e punës “Ftues”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

**NJOFTON:**

Filimin e procedurës së hapur për konkurimin e kandidatëve të interesuar për pozicionin e punës “Ftues”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë..

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data : 03.03.2026

Kandidatët e interesuar për tu pranuar për pozicionin e punës së lart përmendur duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të punës si më poshtë:

**-Kushtet e përgjithshme :**

- Të jetë shtetas shqiptar;

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, si dhe të mos jetë apo të mos ketë qënë nën hetim;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore në marrëdhënie pune dhe/ose shërbim civil,që nuk është shuar sipas ligjit;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm.
- Të ketë njohuri mbi Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;
- Të ketë njohuri mbi Ligjin Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

**-Kushte të veçanta :**

- Të ketë arsimin e mesëm
- Të ketë patent të klasit B
- Të ruaj sekretin hetimor
- Të ketë aftësi ndërvepruese të nivelit profesional me stafin e prokurorisë
- Të ketë aftësi komunikimi etik dhe profesional me publikun dhe punonjësit e institucioneve të tjera.

Personat e interesuar duhet të paraqesin pranë sektetarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, der më datë . 03.03.2026 ora 16:00, dokumentat e kërkuara si më poshtë:

1. Kërkesë për punësim
2. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës
3. CV (jetëshkrim)
4. Diplomë e shkollës së mesme
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata, që nuk ndiqet penalisht
7. Vërtetim mjekësor për gjëndjen shendetsore
8. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimet e mëparshme.
9. Çdo lloj dokumenti tjetër që provon aftësitë e tij/saj profesionale

Konkurimi për pozicionin e punës “Ftues”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, do të zhvillohet në dy faza:

**Faza e parë:** Verifikimi i dokumentave që do të bëhet nga Komisioni i ngritur me urdhërin Nr. 05/1 datë 17.02.2026 , me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në këtë njoftim, si dhe pikëzimi për dokumentacionin përkatës.

*-Dokumentacioni maksimumi 60 pikë*

**Faza e dytë:** Intervista e strukturuar me gojë.

*-Intervista maksimumi 40 pikë*

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet duke u bazuar në pikët e marra nga dokumentacioni i dorëzuar dhe ato të intervistës së strukturuar me gojë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, do të shpallë fituesin në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al).

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJTHSHËM  
LEZHË**